



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 4 prot.

Kamëz, më 21. 3.2025

V E N D I M
Nr. 19.Datë 21/3 2025
MBI

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR DJEGIE BANESE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 21.03.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.18 Datë 17.03.2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 30, pika gj; VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.239, datë 10.03.2025, për evidentimin, konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesë, relacionit të hartuar nga ekspertët e administratës së Bashkisë në zbatim të urdhërit, dhe V.K.B. Kamëz Nr. 119, datë 19.12.2024 “Për miratimin e detajuar të buxhetit për vitin 2025 dhe planit të buxhetit për vitet 2025 , 2026, dhe 2027, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për djegie banese të:
z. , për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 23.02.2025.
2. Të akordohet një ndihmë financiare me shumë prej **206,120 (dyqind e gjashtë mijë e njëqind e njëzet)** lekë e cila mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI